

Vendim nr. 126 datë 13.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 13.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (P) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PËRPARIM KOVAÇI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-1504, datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 546, datë 07.04.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 1093, datë 07.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 29, pika 3, 33, 42, 43, 131, shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ngritur akuzën për veprën penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim, me shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga nenet 143, paragrafi i dytë dhe 25 të Kodit Penal (KP) ndaj dy të pandehurve, një prej të cilëve ka qenë edhe kërkuesi. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1558, datë 22.11.2013, ka vendosur, ndër të tjera, deklarinin fajtor të kërkuesit sipas akuzës dhe e ka dënuar me 11 vjet burgim. Ndaj këtij vendimi është ankuar i bashkëpandehuri tjetër dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1122, datë 05.06.2015, ka vendosur prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, me arsyetimin se nuk ishte respektuar procedura ligjore e njoftimit të të pandehurve.

2. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1093, datë 07.04.2016, ndër të tjera, e ka deklaruar sërish fajtor kërkuesin sipas akuzës dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim vetëm i bashkëpandehuri tjetër.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 546, datë 07.04.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs të dy të pandehurit, pra edhe kërkuesi.

4. Kërkuesi ka parashtruar se në datën 03.02.2020 është arrestuar dhe burgosur për efekt të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës së apelit. Gjatë kohës që rekursi i tij ka qenë në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë, ai ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimeve nr. 1093, datë 07.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 546, datë 07.04.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe pezullimin e ekzekutimit të tyre, me pretendimin se gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të tij, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kërkesa për rishikim është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 288, datë 27.05.2020, me arsyetimin se çështja e kërkuesit nuk kishte përfunduar ende, pasi rekursi ishte në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë.

5. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1504, datë 22.11.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, përfshirë edhe rekursin e kërkuesit. Sipas Gjykatës së Lartë, rekursi i kërkuesit nuk mund të pranohej, pasi ai nuk kishte paraqitur ankim në gjykatën e apelit, ndaj pretendimet e tij kishin rënë në dekadencë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se është i pabazuar pretendimi kryesor i kërkuesit për

padijeninë për gjykimin në apel, duke evidentuar se referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, ai jo vetëm që është thirrur dhe ka pasur dijeni për gjykimin, por atij i është pranuar më shumë se një herë kërkesa për shtyrjen e seancës gjyqësore nga gjykata e apelit, e cila, në kushtet e mosparaqitjes së avokatit të zgjedhur prej tij, i ka caktuar mbrojtës kryesisht në respektim të së drejtës së mbrojtjes.

6. Në datën 12.04.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve sipas objektit të ankimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me tjetër trup gjykues.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga nenet 33, pika 1 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për akses*, pasi kërkuesi nuk ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij. Gjykata e Lartë, padrejtësisht, nuk e ka shqyrtuar rekursin e tij, me arsyetimin se ai nuk kishte kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndonëse ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, e cila e ka shqyrtuar çështjen duke tejkaluar kufijtë ligjorë. Për të njëjtat argumente kërkuetit i është cenuar edhe *parimi i sigurisë juridike* dhe *i pritshmërive të ligjshme*.

7.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e KPP-së që rregullojnë ankimin, rekursin dhe parimet e gjykimit penal.

7.1.3. *E drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur*, pasi kërkuesi është gjykuar në mungesë dhe pa pasur dijeni për procesin në shkallë të parë dhe të dytë. Ai është përfaqësuar nga avokatë të caktuar kryesisht dhe mbrojtja ka qenë jo efektive. Avokati i zgjedhur prej tij në datën 29.02.2016, gjatë kohës që procesi po zhvillohej në shkallë të dytë, nuk është njoftuar nga gjykata dhe është zëvendësuar me avokat të caktuar kryesisht.

7.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe alogjik. Gjykata e Lartë, ndonëse shprehet se pretendimet e

kërkuesit kanë rënë në dekadencë, për shkak të mosparaqitjes së ankimit, ajo ka vlerësuar pretendimin që lidhet me padijeninë dhe mosthirrjen e tij në gjykimin në apel.

7.2. *Parimi i zbatimit të ligjit penal favorizues*, i garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, pasi neni 143 i KP-së ka ndryshuar, pas dhënies së vendimit të gjykatës së apelit dhe përpara shqyrtimit të rekursit, me përmbajtje më favorizuese për dënimin penal, ndaj Gjykata e Lartë duhej ta kishte respektuar këtë parim edhe me nismën e saj.

7.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18, pika 1 i Kushtetutës, pasi konflikti është detyrim kontraktor që zgjidhet me padi civile dhe fakti nuk përbën vepër penale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë

dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f” i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të të tria shkallëve, me pretendimin se i janë cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor (në drejtim të së drejtës për akses, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si dhe standardit të arsytimit), parimi i zbatimit të ligjit penal favorizues dhe parimi i barazisë përpara ligjit, të garantuara respektivisht nga nenet 33, pika 1, 42, 29, pika 3 dhe 18, pika 1 të Kushtetutës. Në situatën kur kërkuesi nuk ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji çmon se ai nuk ka shteruar mjetet e ankimit që ka pasur në dispozicion në formë e substancë, ndaj nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

13. Në përfundim, Kolegji vlerëson se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.